

RAPORTI VJETOR 2011 I SHËRBIMIT LIGJOR FALAS TIRANË (TLAS)

Ky Raport Vjetor pasqyron aktivitetin e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë gjatë vitit 2011 dhe përpiqet të japë një vështrim të përgjithshëm, të saktë dhe informues mbi punën dhe performancën për realizimin e objektivave, metodologjinë e përdorur nga stafi, studentët, vullnetarët dhe partnerët, arritjet kryesore të shërbimit, të dhëna statistikore dhe histori të vërteta/raste studimore. Shpresojmë që informacioni i ofruar të jetë i dobishëm dhe i kuptueshëm për lexuesit e interesuar.

Raporti Vjetor i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, mbulon periudhën Janar 2011 – Dhjetor 2011 dhe është në përputhje me kërkesat dhe kushtet e Raportit Vjetor të Auditimit & Administrimit Financiar.

Të dashur përfitues, donatorë dhe partnerë të TLAS,

Më lejoni t'ju prezantoj Raportin Vjetor 2011, të Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, TLAS.

Edhe këtë vit aktivitetet e TLAS kanë patur si pikënisje prioritetet strategjike të parashikuara në planin afat-mesëm 2010-2013.

Gjatë 2011, TLAS vazhdoi të përqëndrohet në informimin dhe këshillimin ligjor të grupeve në nevojë, si dhe në përfaqësimin e tyre në gjykatë e administratë; vazhdoi aktivitetet ndërgjegjësuese në komunitet përmes “street law” dhe shërbimeve “mobile”; vazhdoi punën e nisur për ngritjen e kapaciteteve përmes workshopeve e trainimeve të organizatave me bazë komunitare dhe të punonjësve të administratës shtetërore që ofrojnë shërbime për njerëzit në nevojë; vazhdoi punën me nisma të reja për përmirësime ligjore në favor të interesave të grupeve vulnerabël si dhe fushatat advokuese dhe lobuese për miratimin e tyre.

Viti 2011 dallohet përsëri si viti i trajnimeve të punonjësve të gjendjes civile dhe administratorëve të ndihmës ekonomike në shkallë vendi, për trajnimin e avokatëve për një zbatim më efikas të ligjit “Për Gjendjen Civile, “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Sociale”, “Për ndihmën Juridike”.

Gjithashtu, viti 2011 pasuron arkivin e nismave të TLAS për përmirësime të legjislationit. Ekspertët e TLAS punuan për Studimin e Legjislationit të Taksave dhe Tarifave në Republikën e Shqipërisë, draftuan aktet nënligjore të Ligjit për ndihmën juridike të cilat u miratuan nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike në qershor 2011.

Përmes Raportit Vjetor 2011, shpresoj të kemi dhënë për lexuesit e interesuar një informacion të dobishëm mbi punën dhe performancën e TLAS, mbi metodologjinë e përdorur nga stafi, studentët, vullnetarët dhe partnerët, mbi të dhënat statistikore dhe disa histori të vërteta përfaqësuese të grup klientëve tanë.

Përfitoj nga rasti të falenderojë donatorët e projekteve të TLAS, përfituesit direkt nga puna që bën TLAS, si dhe partnerët tanë të shumtë,

Sinqerisht,

*Raimonda BOZO
Drejtore Ekzekutive e TLAS*

I - INFORMACION PER SHERBIMIN LIGJOR FALAS TIRANE (TLAS) GJATE VITIT 2011

Viti 2011 dhe një vit të suksesshëm të dekadës së dytë të aktivitetit të TLAS. Me ndihmën dhe mbështetjen e donatorëve, partnerëve, stafit dhe përfituesve e klientëve të tij, TLAS vazhdon të bëjë hapa cilësorë në ofrimin e shërbimeve, në zgjerimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe në ndërmarrjen e nismave për përmirësimin e legjislacionit. Në kuadrin e riorganizimit të pandërprerë për t'ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të grupeve të synuara, për të përballuar vështirësitë dhe sfidat, TLAS i përqëndroi përpjekjet në zbatimin e një strategjie sa më eficiente për ngritjen e fondeve, në mënyrë që të sigurohej vazhdimësia e aktivitetit të organizatës, të respektohej misioni dhe sigurohej cilësia e shërbimeve të ofruara për kategoritë më vulnerabël në Tiranë dhe rrethet tjera të vendit tonë.

Gjatë vitit 2011, TLAS vazhdoi zbatimin e projekteve të tij në fushën e ofrimit të shërbimeve ligjore për njerëzit në nevojë, organizimin e tryezave dhe seminareve me punonjësit e strukturave shtetërore; studime e analiza për ndërhyrje të mundshme në legjislacion me qëllim rritjen e aksesit të individëve dhe familjeve në nevojë në shërbimet sociale dhe ligjore. Gjithashtu, TLAS zhvilloi mjaft aktivitete të ndërgjegjësimit ligjor të komuniteteve dhe individëve në nevojë, nëpërmjet aktiviteteve të *Street law*, duke organizuar vizita dhe takime në zonat ku ndodhen komunitetet dhe individët vulnerabël.

Edhe gjatë vitit 2011, prioritet i TLAS ishte ofrimi i shërbimeve ligjore të plota për pjesëtarët e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian, si shtresat më të marxhinalizuara dhe më të diskriminuara të shoqërisë shqiptare. Ofrimi i shërbimeve ligjore konsiston në ofrimin e shërbimeve ligjore për regjistrimet civile për këto komunitete, në mënyrë që ata të përfitojnë të drejtat bazë ligjore dhe sociale.

TLAS vazhdoi zbatimin e suksesshëm të projektit “Rritja e Aksesit në Drejtësi për Grupet Vulnerabël”, ku u vizituan të gjitha Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për përfaqësimin në gjykata të të gjitha atyre personave të cilët kualifikohen për të përfituar nga dënimet alternative, të cilët plotësojnë kriteret e përzgjedhjes së TLAS dhe përfshihen në grupet e synuara nga TLAS.

Gjatë vitit 2011, TLAS zbatoi me sukses projektet e mëposhtme:

Titulli i Projektit	Donatori	Shuma	Kohëzgjatja	Kontakti
Rritja e aksesit në drejtësi për komunitetet vulnerabël	Fondacioni Vodafone Albania	2,750.751 ALL	01.04.2011 – 31.03.2012	Z. Albi Greva + 04 2283267 albigreva@vodafone.com
Përmirësimi i Shërbimeve të Ndihmës Ligjore për Pakicat	CRD (Civil Rights Defenders), ish Komiteti Suedez i Helsinkit	72,000 Euro	01.03.2011 - 31.12.2011	Znj. Marie Manson + 46 8 545 277 54 marie.manson@civilrightsdefenders.org
Fuqizimi i grupeve	UNICEF	8,320,434 ALL	15.03.2011 - 15.03.2012	Znj. Mirlinda Bushati + 355 692056827

vulnerabël për akses në shërbimet ligjore				mbushati@unicef.org
Fuqizimi i grupeve vulnerabël për akses në shërbimet ligjore	UNDP	6,053,500 ALL	15.07.2011 – 15.07.2012	Z. Bujar Taho + 355 692082245 Bujar.Taho@undp.org
Pëmirësimi i Sistemit të Ndihmës Ligjore në Shqipëri	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	338,800 ALL	22.11.2010 – 22.11.2011	Znj. Iris Beleraj + 355 694082461 irisi.belereaj@amshc.gov.al
Rritja e Aksesit në Drejtësi për Grupet Vulnerabël	Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri (EIDHR)	147, 000 Euro	17.11.2009 – 30.08.2011	Znj.Marzia Dalla Vedova EuropeanCommission E-mail: marzia.dalla-vedova@ec.europa.eu

II. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT TE TLAS

Misioni i TLAS: Përmeshja e nevojave sociale dhe ligjore të njerëzve në nevojë; edukimi dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë shqiptare për shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut; nxitja e përmirësimeve në legjislacionin shqiptar; përparimi i komunitetit dhe forcimi i demokracisë në Shqipëri.

Vlerat e TLAS: Sjellja e ndryshimeve të reja nëpërmjet besimit, respektit, shërbimit dhe punës me të tjerët.

Vizioni i TLAS: Një sistem ligjor falas i ri dhe bashkëpunues që i përgjigjet nevojave të personave me të ardhura të pamjaftueshme.

Objektivat: Ofrimi i shërbimeve ligjore për njerëzit në nevojë; Publikimi i informacioneve të rëndësishme ligjore dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë shqiptare për shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut; Avokati dhe lobim për përmirësimin e legjislacionit për zgjidhje më të mirë të problemeve.

Metodologjia e TLAS për të ofruar me cilësi dhe përkushtim një seri shërbimesh që përfshijnë informimin, edukimin, këshillimin dhe përfaqësimin ligjor të personave në nevojë përbëhet nga:

a. Shërbimet

- *Paraligjore* (zgjidhjen e çështjeve ligjore në rrugë administrative);
- *Ligjore* (zgjidhjen e çështjeve nëpërmjet procedurave gjyqësore);
- *Lawline* (këshillim ligjor nëpërmjet telefonit);
- *Clinics* (përgatitja ligjore e klientëve për vetëpërfaqësim para organeve shtetërore dhe gjykatës);
- *Ndërmjetësimi* (zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve);
- *Shërbimet “Mobile”* (shërbime ligjore të ofruara ndaj klientëve në zona të largëta me mundësi të kufizuara).

b. Aktivitete të “Street law”: Publikim, informim, edukim dhe ndërgjegjësim ligjor i komunitetit

TLAS organizon vizita dhe takime përmes aktiviteteve të “Street law” në zonat urbane dhe rurale të Tiranës dhe qyteteve të tjera, publikon botime të ndryshme ligjore për këto aktivitete të shkruara në një gjuhë të thjeshtë për përdorim publik. Gjithashtu, TLAS boton çdo katër muaj revistën e tij, e cila pasqyron nevojat ligjore të komunitetit dhe shërben si burim informacioni dhe edukimi për grupet e synuara.

c. Monitorimi i aktiviteteve në sistemin ligjor

TLAS ka përgatitur disa raporte monitoruese: Raportin mbi nivelin e korrupsionit në Sistemin e Noterisë; Raportin mbi aktivitetin e Zyrrave të Përmbarimit në Shqipëri; Raportin mbi funksionimin dhe punën e Administratës Gjyqësore; Raportin mbi monitorimin e nivelit të krenaqësisë së publikut ndaj shërbimeve të ofruara nga Gjykatat, etj.

d. Aktivitete të fushës së avokatisë dhe lobimit

TLAS i kushton vëmendje të veçantë aktiviteteve të avokatisë dhe lobimit për ndërmarrjen e nismave ligjore, si për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, ashtu edhe për hartimin e ligjeve të reja, të diktura dhe identifikuar nga problemet që hasin grupet në nevojë.

TLAS është përfshirë në nismën ligjore për ndryshimin e ligjit Nr. 7698, datë 15. 04. 1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, ndryshime të cilat u miratuan në Korrik 2004; TLAS draftoi amendimin e ligjit Nr 8950 “Për gjendjen civile”, ndryshime të cilat u miratuan në Korrik 2008; TLAS hartoi ligjin “Për Ndihmën Juridike”, ligj i cili u miratua në Dhjetor 2008.

Gjithashtu, TLAS ka përgatitur ndryshimet e kuadrit ligjor për veprimtarinë e stafit të administratës gjyqësore, u përfshi në përgatitjen e akteve nënligjore për profesionin e avokatit në Shqipëri, mbështeti kategorinë e ushtarakëve të aksidentuar gjatë detyrës për hartimin e akteve ligjore për përfitimin e paaftësisë, mbështeti dhe hartoi aktet nënligjore të ish të dënuarve për krime jo-politike gjatë periudhës 1945-1990 në mënyrë që t’ju njihen vitet e punës gjatë denimit në llogaritjen e pensionit të pleqërisë, etj.

Në vitin 2009 TLAS përgatiti një studim dhe analizë të hollësishme të kuadrit ligjor për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, analizë, e cila ndihmoi për hartimin dhe amendimin e ndryshimeve ligjore të legjislacionit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, të cilat u miratuan në 18 Mars, 2011. Nëpërmjet këtyre përmirësimeve, TLAS synon përshirjen në skemën e shërbimeve dhe ndihmës shoqërore, të kategorive në nevojë që për shkak të boshllëqeve ligjore nuk janë përfshirë në këtë skemë. ose ndikojnë në përjashtimin e familjeve të komunitetit Rom të cilat nuk plotësojnë kriteret e nevojshme.

Gjatë vitit 2010, TLAS u angazhua në hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit “Për Ndihmën Juridike” për të bërë funksional sistemin e ndihmës juridike në Shqipëri, akte të cilat u miratuan në qershor 2011.

Rezultat i punës advokuese dhe lobuese të TLAS janë miratimi në Dhjetor të vitit 2011, i Udhëzimit të Ministrisë së Brendshme për Regjistrimin përmes procedurave administrative të lindjeve të fëmijëve të gjetur apo të braktisur nga prindërit, si edhe i Udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë për ndryshimin e Certifikatës së Asistencës të Lindjeve të lëshuar nga institucionet shëndetësore. Gjithashtu gjatë vitit 2011, TLAS lidhi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Ministrinë e Jashtme, për mundësimin e regjistrimit të lindjeve të fëmijëve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

e. Programi “Internship” i studentëve

Grupe studentësh nga Fakultetet e Drejtësisë dhe të Punës Sociale janë vazhdimisht të pranishëm në TLAS, të përfshirë në aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese të “Street law”, në shërbimet ligjore “Mobile”, në asistimin e menaxhimit të rasteve të klientëve si dhe në projekte të tjera të monitorimit, vëzhgimit, nismave ligjore, trajnimeve, etj.

f. Ngritja e kapaciteteve ligjore të OJF-ve, përfaqësuese të grupeve të synuara të TLAS përmes: Regjistrimit në gjykatë të shoqatave lokale dhe seminareve të trainimit për forcimin e kapaciteteve të tyre ligjore.

g) Aktivitete trainimi për nëpunësit e strukturave shtetërore

- Seminare trainimi për nëpunësit e administratës publike;
- Seminare trainimi për nëpunësit e zyrave të gjendjes civile;
- Seminare trainimi me stafet e gjykatave dhe avokatw privatw;

III. DONATORET


Aktiviteti i TLAS gjatë vitit 2011 është bërë i mundur në sajë të financimeve të:

- Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri
- Fondacioni “VODAFONE ALBANIA”
- UNICEF
- Civil Rights Defenders, CRD (ish-SHC)
- UNDP
- Agjencia për Mbështjetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)

TLAS është anëtar aktiv i Koalicioneve “Koalicioni i OJF-ve Shqiptare kundër Korrupsionit” dhe “Të gjithë kundër Trafikimit të Fëmijëve”.

Financimi i TLAS në vite ka qënë si më poshtë:

FINANCIMI I TLAS NE VITE 1999 - 2011




IV. ZHVILLIMI ORGANIZATIV I TLAS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) e ka filluar veprimtarinë e tij në Janar të vitit 1999 si program i CAFOD Albania, deri në 18 Dhjetor 2006, kur TLAS u regjistrua si organizatë jo fitimprurëse e pavarur në formën e Qendrës.

TLAS funksionon dhe vepron në përputhje me planin strategjik afatmesëm 2011 - 2013, që parashikon në të ardhmen përsosjen cilësore të metodologjisë për arritjen e tre objektivave themelore, atë të shërbimeve, të informimit dhe përmirësimit të legjislacionit. Prioritet i TLAS mbeten problemet sistematike që prekin grupe të njerëzve në nevojë më shumë sesa rastet individuale të klientëve të vecantë, por sigurisht pa lënë pas dore edhe këto të fundit.

TLAS vazhdon të ketë staf mjaft të kualifikuar si për punën me klientët dhe ndjekjen e çështjeve të avokatisë, ashtu edhe për menaxhimin dhe drejtimin e TLAS. Organi më i lartë vendimmarrës është Bordi Drejtues, i përbërë nga 5 anëtarë, të cilët kanë një eksperiencë të gjerë në fushën e ligjit, atë sociale dhe të drejtimit. Aktualisht stafi i TLAS përbëhet nga 8 punonjës me kohë të plotë dhe 1 me kohë të pjesshme. Në kuadrin e Programit të Internship me Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë, TLAS përfshin si pjesë të stafit të tij me kohë të përkohshme edhe studentë nga ky Fakultet.

Struktura organizative e TLAS është si më poshtë:



V. TLAS GJATE 2011

TLAS, bazuar në Planin Operacional 2011, synoi të arrijë objektivat e mëposhtëm:

I.1 Ofrimin e shërbimeve ligjore falas për çështjet civile për më tepër se 1500 individë në nevojë (Romë, pakica të tjera, invalidë, jetimë, pensionistë dhe individë të varfër pa të ardhura të mjaftueshme) në Tiranë, Lushnjë, Fushë-Krujë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Berat, Kukës, Tropojë, Peshkopi, Lezhë, etj.

I.2 Informimi dhe ndërgjegjësimi i më shumë se 5000 individëve në nevojë nga Tirana dhe rrethet e tjera të Shqipërisë për të drejtat ligjore dhe sociale dhe për të drejtën e aksesit në drejtësi.

I.3 Ndërmarrja e nismave për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

V.1 OFRIMI I SHËRBIMEVE LIGJORE FALAS PËR ÇËSHTJET CIVILE

Në fund të Dhjetorit 2011, numri i përgjithshëm i klientëve të TLAS që kishin përfituar shërbim paraligjor, ligjor dhe kliniks arriti shifrën **14691** nga të cilat 8774 janë raste paraligjore dhe 5917 janë raste ligjore.

Vetëm gjatë vitit 2011, u ofruan shërbime në 1628 raste klientësh (900 raste paraligjore dhe 728 raste ligjore), duke përfshirë edhe 87 rastet e transferuara nga viti 2010.

Gjatë vitit 2011 përfituan nga shërbimi i këshillimit ligjor nëpërmjet telefonit (shërbimi *lawline*) 518 individë. Ky numër nuk përfshin numrin e këshillimeve që kanë përfituar këta personave nga paraqitja e tyre personalisht në zyrë, pasi ato janë llogaritur si shërbime të përfaqësimit ligjor.


Edhe gjatë vitit 2011, prioritet pati ofrimi i shërbimeve ligjore ndaj komuniteteve vulnerabël si ai Rom dhe Egjyptian. Numri i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve që përfituan nga shërbimet e TLAS ishte 752. Çështjet kryesore, për të cilat i është ofruar shërbim ligjor këtij komuniteti kanë qenë ato të regjistrimeve civile, si lindje, zgjidhje martesë, rastet e strehimit, raste kujdestarie dhe çështje të tjera administrative.

Gjatë vitit 2011 janë trajtuar me shërbimin *clinics* 420 raste.

Edhe gjatë vitit 2011 prioritet ishte rritja e cilësisë së shërbimit dhe zhvillimit të aktiviteteve informuese për publikimin e TLAS tek grupet potenciale të klientëve.


Statistika

Statistikat përfaqësojnë rastet e TLAS, të cilave iu është ofruar shërbim ligjor dhe




paraligjor falas. Numri total i rasteve në vite mund të shihet në grafikun e mëposhtëm.

TLAS ka ofruar shërbimet sipas llojit dhe grupeve të synuara si më poshtë:



NUMRI I ÇESHTJEVE SIPAS LLOJIT Janar 2011 - Dhjetor 2011



Përfituesit:

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2011 nga shërbimi i TLAS përfituan si më poshtë:

- 1628 përfitues të drejtpërdrejtë, përfshirë 87 raste të transferuara nga viti 2010;
- 518 përfitues nga linja lawline;
- 5042 përfitues direkt nga aktivitetet e Street law në komunitet;
- 747 përfitues direkt nga seminarët e trainimit me anëtarë të shoqatave komunitare, stafin e zyrave të gjendjes civile, stafin e gjykatave, etj.
- 16000 përfitues indirekt nga aktivitetet e TLAS gjatë vitit 2011.

Duke marrë parasysh vështirësitë me të cilat është përballur TLAS, në sistemin gjyqësor dhe administratën publike, mund të thuhet se cilësia e shërbimit të tij ka qenë e kënaqshme dhe konkretisht gjatë vitit 2011, 88% e rasteve të trajtuara në rrugë gjyqësore kanë qenë të suksesshme dhe 98 % e rasteve të trajtuara në rrugë administrative kanë qenë të suksesshme.

Ndarja sipas llojit të çështjes gjatë vitit 2011: më tepër se 20 % e rasteve kanë të bëjnë me regjistrimin e lindjeve; 13% me sistemin e përfitimeve shoqërore, 16% janë çështje familjare; 7% janë raste strehimi; 8 % janë çështje pronësie, etj;

Ndarja sipas grupet të synuara gjatë vitit 2011 shfaqet si më poshtë: 26 % jane familje në nevojë; 24 % janë të papunë, 18% gra kryefamiljare me të ardhura të pakta; 11% janë pensionistë; 14% janë persona me aftësi të kufizuara, ish të persekutuarit dhe fëmijë të braktisur; 8% persona të dënuar, për rastet e dënimeve alternative.

Cilësia e Shërbimit

Cilësia është parë si domosdoshmëri për të përmbushur nevojat dhe shpresat e klientëve dhe si kriter për plotësimin e objektivave e standarteve të miratuara për këtë

qëllim. Për rritjen e cilësisë së shërbimit janë ndërmarrë këto hapa:

- Miratimi i Planit Operacional të 2011, i Rregullores së Brendshme të TLAS si dhe i politikave të tjera të zhvillimit organizativ, kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe koordinimit të aktiviteteve në përgjithësi.
- Dihet që TLAS ofron këshillime e shërbime ligjore për çështjet civile dhe organizimin i punës sipas specialitetit të avokatit, bazuar në llojin, objektin dhe shkallën e vështirësisë. Trajtimi në mënyrë të vazhdueshme në grupin këshillimor të avokatëve të TLAS për çështje të mosmarrëveshjeve familjare, regjistrimit të lindjeve, të pronësisë, mosmarrëveshjet e punës, të sigurimeve dhe pensioneve, etj kanë ndihmuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimeve.
- Mbledhjet e rregullta të stafit kanë ndihmuar në përmirësimin e procedurave që kanë të bëjnë me punën me klientët dhe me koordinimin e punës në grup të stafit të TLAS, që do të thotë se këshilltari, avokati, financieri dhe studentët e programit internship ndajnë detyrat specifike në mënyrë që aktiviteti apo çështja e klientit të kompletohet në kohën e duhur.
- Vazhdimi i zbatimit të politikës “Përzgjedhja e rasteve të bazuara ligjërisht” dhe “Përdorimi i Ndërmjetësimit nga TLAS” ka rritur shkallën e suksesit në trajtimin e çështjeve të klientëve.
- Zbatimi i Procedurave të Ankimit, filluar që në Mars 2002 i jep të drejtë klientëve të ankohen përpara Drejtorit Ekzekutiv të TLAS për cilësinë e shërbimit që i ofrohet.
- Përdorimi i Bazës së të Dhënave “Clients 2000” është një nga mjetet më të rëndësishme ku mbështetet cilësia e shërbimit, jo vetëm për saktësinë e regjistrimit të të dhënave të klientëve, të llojit të rasteve por konsiderohet në të njëjtën kohë dhe faza e parë e vlerësimit të nevojave ligjore të komunitetit. Baza e të Dhënave “Kemp’s Case Works”, cili përdoret nga shumë Shoqëri të Ndihmës ligjore në të gjithë botën është instaluar nga TLAS që në vitin 2002.
- Aktiviteti i TLAS është shqyrtuar dhe vlerësuar rregullisht nga konsulentë të jashtëm të pavarur, kryesisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar. Janë bërë 8 Raporte Vlerësimi në një periudhë 10 vjeçare duke filluar nga eksperti Tony Trott, i Ndihmës Ligjore në Mbretërinë e Bashkuar; Richard Langan i Universitetit të Columbia, SHBA; Bruce Perrone dhe Barbara Bays nga Ndihma Ligjore e Virxhinias Perëndimore, SHBA; Rosemary French dhe Marie Contreras nga Instituti Benchmark i San Francisco, SHBA; përfaqësues të Bashkimit Europian në kuadrin e Projektit CARDS, nga Daniel Manning, Grater Legal aid Boston, etj. Rekomandimet e konsulentëve janë përqëndruar kryesisht në menaxhimin e rasteve, qëndrueshmërinë e projektit dhe zhvillimin strategjik. Raportet Vjetore të TLAS, përfshirë dhe auditimin e pavaruar financiar, publikohen çdo vit në formë të shtypur dhe atë elektronike dhe i shpërndahen përfituesve dhe aktorëve kryesorë të fushës.
- Përmirësime cilësore janë arritur dhe përmes bashkëpunimit dhe referimit të çështjeve tek institucionet dhe zyrat partnere të ndihmës ligjore si në Zyrën e Avokatit të Popullit, në Klinikën Ligjore për të Miturit, Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave të Paaftë, në Qendrat për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në Qendrën për Iniciativa Ligjore dhe Qytetare (ish-Qendrën Avokatore për Gratë), në Komitetin e Helsinkit, etj, të cilët kanë në fokus të veprimtarisë

së tyre mbështetjen e grupeve të varfëra. Bashkëpunimi me shërbimet e mësipërme konsiston jo vetëm në referimin reciprok të klientëve, por edhe në zbatimin e projekteve të përbashkëta. TLAS ka zbatuar projekte të përbashkëta me Institutin European të Tiranës, Qendrën Për Iniciativa Ligjore dhe Qytetare, Terre Des Home, Partners for Children, Qendrën për Zgjidhjen e Konfliktëve e Mosmarrëveshjeve, me organizatat Rome, Unionin Amaro-Drom, koalicionin e BKTF, etj.

- Nga ana tjetër TLAS ka bërë hapa shumë pozitive për të forcuar marrëdhëniet me organet shtetërore, veçanërisht Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Bashkinë e Tiranës, duke nënshkruar me to edhe Marrëveshje Bashkëpunimi.

V.2 INFORMIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I INDIVIDËVE NË NEVOJË PËR TË DREJTAT LIGJORE DHE SOCIALE DHE PËR TË DREJTËN E AKSESIT NË DREJTËSI.

Informimi dhe ndërgjegjësimi i më shumë se 6000 individëve në nevojë nga Tirana dhe rrethet e tjera të Shqipërisë për të drejtat ligjore dhe sociale dhe për të drejtën e aksesit në drejtësi.

i) Aktivitetet e “Street law”



Në vijim të shërbimeve ligjore në zyrë, TLAS ka organizuar aktivitete të “Street law” për shpërndarjen e botimeve, për publikimin e informacioneve të thjeshta ligjore e komunikimin direkt me përfituesit.

Numri i studentëve vullnetarë nga Fakultetet e Drejtësisë dhe Punës Sociale, pjesë e programit të intership në TLAS ka ardhur duke u rritur. Ata punojnë me pasion si në fazën parapërgatitore të grumbullimit të fletëpalosjeve dhe broshurave, edhe në identifikimin e temave që duhet t’i interesojnë komunitetit.

Gjatë vitit 2011, grupet e *street law* të TLAS kanë realizuar 48 aktivitete si vizita dhe takime të planifikuara, në Rrethin e Tiranës, Durrës, Vlorë, Lushnjë, Burrel, Tropojë, Elbasan, Krujë, Fushë-Krujë, Lezhë, Berat, Peqin, Shkodër, Kukës, Gjirokastrë, Korçë, Pogradec, Fier, etj.

Disa nga temat e zgjedhura për aktivitetet e *street law* përfshinin:

- Ligjin e Gjendjes Civile dhe ndryshimet e tij;
- Legjislacioni i përkrahjes sociale dhe përmirësimi i tij;
- Çfarë është akses në drejtësi dhe të drejtat ligjore themelore të individit;
- Të drejtat e grupeve vulnerabël për strehim, arsim dhe kujdesin shëndetësor;
- Njohuri të përgjithshme mbi Ligjin "Për Ndihmën Juridike", etj.



Vizitat në komunitet janë takime informale dhe kanë si objekt bisedat e stafit të TLAS me persona të komunitetit, takimin me persona në rrugë dhe në vende ku mbledhen njerëzit, shpërndarjen e informacionit si fletëpalosje dhe broshura, etj. si dhe identifikimin e problemet e individëve të cilët kanë nevojë për ndihmë ligjore.



Takimet në Komunitet janë takime më formale dhe synojnë organizimin e takimeve ku ftohen zyrtarë të pushtetit vendor dhe përfitues të shërbimeve të TLAS. Në vijim të ofrimit të shërbimeve ligjore për çështjet, takimet ndihmojnë TLAS për të vlerësuar problemet e vecanta të komunitetit dhe nevojat e tyre si dhe marrin mendimin e komunitetit për aktivitetet e zhvilluara të *street law*.

Shpesh prioritetet e shërbimeve të TLAS bazohen në probleme të identifikuara gjatë takimeve të *street law*. Këto takime ndikojnë ndjeshëm për përsosjen e metodologjisë së punës të stafit të TLAS duke përfshirë dhe shërbimin “mobile” në veçanti. Gjatë aktiviteteve të *street law* automjeti i TLAS pajiset si “shërbim ligjor mobile” me të gjitha mjetet e nevojshme (laptop, printer, etj) për t’i dhënë mundësi përfituesve të marrin direkt në terren ndihmën e parë ligjore nga stafi.

Revista periodike e TLAS dhe publikime të tjera:

Stafi i TLAS ka përgatitur dhe botuar 3 numra të revistës së tij (**nr. 1/2011, 2/2011 dhe 3/2011**) të financuara përkatësisht nga Bashkimi Europian, UNICEF dhe CRD (Civil Rights Defenders), (ish-Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut). Revista e TLAS është një botim i thjeshtë për edukimin dhe informimin ligjor të grupeve të synuara dhe komunitetit të TLAS i shkruar në një gjuhë të kuptueshme për tema të ligjore, që prekin dhe trajtojnë problemet më të ndjeshmë të klientëve të TLAS.



Numri 1, 2011, përmban artikuj për aktivitetin e TLAS për rritjen e aksesit në drejtësi për grupet vulnerabël, në lidhje me fëmijët dhe shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët e braktisur, pakicat e komuniteti Rom; pasojat e zgjidhjes së martesës për ish-bashkëshortët; pensionet e pleqërisë, procedurat për aplikimet, ankimet administrative dhe gjykimet; mbrojtja nga diskriminimi dhe garancitë që ofron ligji; histori të vërteta.

	Numri 2, 2011 përmban artikuj për regjistrimin e fëmijëve; parimi i interesit më të lartë të fëmijës në të drejtën familjare; pensionet e pleqërisë, procedurat për aplikimet, ankimet administrative dhe gjykimet; ankimi kundër vendimeve të Komisionit të caktimit të aftësisë për punë (pensionet e invaliditetit); seminarët me punonjësit e zyrave të gjendjes civile; histori të vërteta.
	Numri 3, 2011 përmban artikuj për forumin për ndihmë ligjore në Ballkan; detyrimi për ushqim si një nga pasojat e zgjidhjes së martesës; shtetësia shqiptare, fitimi, humbja dhe rifitimi i saj kundërshtimi i atësisë; regjistrimi i fëmijëve të lindur jashtë shtetit; histori të vërteta.

Janë botuar dhe shpërndarë rreth 17000 fletëpalosje e postera, ku pjesë të konsiderueshme zënë ato të ndryshimeve të Ligjit të gjendjes civile, të aksesit në drejtësi, të ligjit për Ndhimën Juridike, etj. Shpërndarja e tyre është realizuar gjatë aktiviteteve të Street laë, seminareve me grupet e synuara, në tryezat e rrumbullakta, në të gjitha zyrat e gjendjes civile në shkallë vendi, në strukturat lokale dhe qendrat shëndetësore, etj. Faqja e Internetit të TLAS www.tlas.org.al, është përditësuar vazhdimisht.

Gjate viti 2011, TLAS hartoi dhe publikoi përmbledhjen e legjislacionit për ndihmën juridike; përmbledhjen e legjislacionit për shërbimin e gjendjes civile; udhëzuesin për raste të ndryshme të regjistrimit të fëmijëve në zyrën e gjendjes civile.



Shërbimet "Mobile"

Shërbimi ligjor "mobile" gjatë 2011 ka qënë pjesë përbërëse e *Street law*, ku avokati dhe këshilltari i TLAS, të cilët udhëtojnë me të gjitha pajisjet e nevojshme teknike (laptop, printer, kancelari) përgatit dokumentacionin e nevojshëm për raste të transferimit të vendbanimeve, regjistrimit të lindjeve, raste familjare, administrative apo raste të tjera të identifikuara në takim. Ofrimi i shërbimit direkt në terren përmes këshillimit apo përgatitjes së dokumentave të klientëve synon përsheptimin e procedurave, shmangien e vonesave dhe shpenzimeve të tepërta të përfituesve.

Programi i Internship-it

Gjatë 2011 në Programin e Internshipit në zyrat e TLAS janë përfshirë më tepër se 20 studentë të Fakultetit të Drejtësisë dhe të Punës Sociale. Programi pasqyrohet jo vetëm në 48 aktivitetet e *Street law* të organizuara gjatë vitit 2011 por edhe në faktin që studentët e këtij programi konsiderohen si asistentë të përditshëm të punës së avokatëve dhe këshilltarëve TLAS. Mbi bazën e një kalendari pune të ndërtuar nga vetë studentët, ata janë pjesë e në procesit të intervistimit të klientëve, pjesë e shërbimeve të tjera të ofruara nga TLAS si depozitimi i kërkesave në gjykatë, përgatitja e akteve ligjore të thjeshta, shoqërimi i klientëve tek noteri, si dhe në punë të tjera administrative të zyrës.

V.3 NDËRMARRJA E NISMAVE PËR PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT:

TLAS në mënyrë të pandërprerë është angazhuar në përmirësimin e legjislacionit shqiptar dhe në aktivitetet e lobimit dhe avokatisë, në mbrojtje të interesave të shtresave më vulnerabël.

Disa nga nismat më të rëndësishme ligjore të ndërmarra nga TLAS gjatë historisë së tij dhe gjatë vitit 2010 janë:

1. TLAS u përfshi në nismën ligjore lidhur me ndryshimin e ligjit Nr. 7698, datë 15. 04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", ndryshime të cilat u pasqyruan në ligjin e miratuar në Korrik 2004;
2. TLAS hartoi ndryshime ligjore të ligjit Nr 8950 "Për gjendjen civile", ndryshime të cilat u miratuan në Korrik 2008.
3. TLAS hartoi ligjin shqiptar "Për Ndhimën Juridike", ligj i cili u miratua në 22 Dhjetor 2008;
4. TLAS përgatiti ndryshimet e kuadrit ligjor për veprimtarinë e stafit të administratës gjyqësore, duke hartuar në vitin 2004 disa ndryshime të akteve nënligjore;
5. TLAS u përfshi në përgatitjen e akteve nënligjore për profesionin e avokatit në Shqipëri, për përfshirjen e avokatëve të ndihmës ligjore në avokatët e kategorive të larta;
6. TLAS mbështeti kategoritë e ushtarakëve të paaftë fizikisht për hartimin e akteve ligjore për përfitimet e tyre nga paaftësia;
7. TLAS mbështeti për hartimin e akteve nënligjore individët e dënuar për krime jo-politike në periudhën 1945-1990, në mënyrë që t'u njihet periudha e punës së kryer gjatë vuajtjes së dënimit për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë;

8. Në vitin 2009 TLAS përgatiti një studim dhe analizë të hollësishme të kuadrit ligjor për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, analizë, e cila ndihmoi pwr hartimin dhe amendimin e ndryshimeve ligjore të legjislacionit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, të cilat u miratuan në 18 Mars, 2011. Nëpërmjet këtyre përmirësimeve, TLAS synon përshirjen në skemën e shërbimeve dhe ndihmës shoqërore, të kategorive në nevojë që për shkak të boshllëqeve ligjore nuk janë përfshirë në këtë skemë. ose ndikojnw nw përjashtimin e familjeve tw komunitetit Rom të cilat nuk plotësojnë kriteret e nevojshme.
9. Gjatë vitit 2010, TLAS u angazhua në hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit “Për Ndihmën Juridike” për të bërë funksional sistemin e ndihmës juridike në Shqipëri, akte tw cilat u miratuan nw qershor 2011.
10. Rezultat i punws advokuese dhe lobuese tw TLAS janw miratimi nw Dhjetor tw vitit 2011, i Udhwzimit tw Ministrisw sw Brwndshme për Regjistrimin pwrmes proceduarave administrative tw lindjeve tw fwmijwve tw gjetur apo tw braktisur nga prindwrit, si edhe i Udhwzimit tw Ministrisw sw Shwndetwsisw pwr ndryshimin e Certifikatws sw Asistencws nw Lindje tw lwshuar nga institucionet shwndetwsore. Gjithashtu gjatw 2011, TLAS lidhi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Ministrinë e Jashtme, për mundwsimin e regjistrimit të lindjeve tw fwmijwve jashtë territorit tw Republikës së Shqipërisë;

V.4. Seminaret trainuese dhe informuese

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) ka zhvilluar seminare dhe trainime të ndryshme në kuadrin e ndërgjegjësimit të organeve shtetërore për nevojat e grupeve të synuara të TLAS.

Gjatë vitit 2011, TLAS ka realizuar 28 seminare, trainime dhe tryeza të ndryshme me punonjësit e zyrave të gjëndjes civile për njohja dhe interpretimin e ligjit të gjëndjes civile në kushtet e kuptimit të ndryshimeve në ligj; me shoqata komunitare për ndërgjegjësimin dhe rritjen e aksesit të komuniteteve vulnerabël në të drejtat dhe shërbimet civile; si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe zbatimin e Ligjit “Për Ndhimën Juridike”, si më poshtë:

Seminare informuese dhe trainuese me organizatat komunitare



Tiranë, 11. 11. 2011, seminar me administratorwt e ndihmws ekonomike dhe OJF-të lokale, me temë "Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë në Shqipëri";



Elbasan, 16. 11. 2011, seminar me OJF-të lokale, me temë "Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë në Shqipëri";



Shkodër, 18. 11. 2011, seminar me OJF-të lokale, me temë "Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë në Shqipëri";



Fier, 21. 11. 2011, seminar me OJF-të lokale, me temë "Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë në Shqipëri";



Durrës, 24. 11. 2011, seminar me OJF-të lokale, me temë "Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë në Shqipëri";



Tiranë, 14. 12. 2011, seminar me OJF-të lokale, me temë "Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë në Shqipëri";

Seminare informuese dhe tryeza për përmirësimin dhe zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike me administratorët e ndihmës ekonomike dhe përfaqësues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta



Durrës, 02. 06. 2011, seminar me administratorët e ndihmës ekonomike temë " Rritja e aksesit në drejtësi dhe në të drejtat ligjore të grupeve vulnerabël".



Elbasan, 03. 06. 2011, seminar me administratorët e ndihmës ekonomike temë " Rritja e aksesit në drejtësi dhe në të drejtat ligjore të grupeve vulnerabël;



Shkodër, 07. 06. 2011, seminar me administratorët e ndihmës ekonomike temë " Rritja e aksesit në drejtësi dhe në të drejtat ligjore të grupeve vulnerabël";



Fier, 09. 06. 2011, seminar me administratorët e ndihmës ekonomike temë " Rritja e aksesit në drejtësi dhe në të drejtat ligjore të grupeve vulnerabël;



Tiranë, 14. 06. 2011, seminar me administratorët e ndihmës ekonomike si dhe përfaqësues të Ministrisë së Punës, Shërbimeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, me temë "Ndërgjegjësimi dhe rritja e aksesit të komuniteteve vulnerabël në të drejtat dhe shërbimet civile";

Trainime me punonjësit e Zyrave të Gjendjes Civile



Elbasan, 26. 03. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: "Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Lezhë, 02. 04. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: "Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Kavajë, 09. 04. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: "Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Fier, 16. 04. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: "Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Peshkopi, 21. 05. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: "Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Kukës, 27. 05. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: “Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Tropojë, 28. 05. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: “Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Krujë, 04. 06. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: “Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Sarandë, 11. 06. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: “Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Tiranë, 16. 06. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: “Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Tiranë, 17. 06. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: “Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";



Tiranë, 18. 06. 2011, trainim me punonjës të Gjendjes Civile, me temë: “Përmirësime të mëtejshme të zbatimit të ndryshimeve të legjislacionit "Për Gjendjen Civile";

Tryeza dhe seminare për përsosjen e sistemit të ndihmës juridike



Tiranë, 06. 04. 2011, seminar me temë “Përsosja e sistemit për ofrimin e Ndihmës Juridike kusht për rritjen e aksesit në drejtësi të individëve në nevojë”;



Vlorë, 23. 09. 2011, seminar me temë “Përsosja e sistemit për ofrimin e Ndihmës Juridike kusht për rritjen e aksesit në drejtësi të individëve në nevojë”;



Shkodër, 30. 09. 2011, seminar me temë “Përsosja e sistemit për ofrimin e Ndihmës Juridike kusht për rritjen e aksesit në drejtësi të individëve në nevojë”;

Tryeza për ndihmën ligjore dhe bashkëpunimin rajonal



Tiranë, 25 dhe 26. 05. 2011, tryezë me temë: “Ndihma Ligjore dhe Paanësia në Gjykatë”;



Durrës, 11 - 12. 10. 2011, takimi i tretë rajonal në kuadër të Nismës së Ohrit për Ndihmën Juridike;

VI. QENDRUESHMERIA DHE VAZHDIMESIA

Oëndrueshmëria

Programi i TLAS, i përbërë nga projekte të larmishme në funksion të ofrimit të

shërbimeve, të edukimit dhe informimit si edhe të përmirësimit të legjislacionit, është konceptuar dhe zbatuar si një program i qëndrueshëm. Deri tani TLAS është financuar me sukses nga donatorët. Krijimi i një sistemi shtetëror, institucional të ndihmës juridike dhe të mëbshtetjes së shoqërisë civile, ka rritur mundësitë e financimit të TLAS por edhe të kapaciteteve të tjera të kualifikuara për shërbim ligjor falas nga vet buxheti i shtetit. TLAS synon dhe pretendon të konkurojë me shërbime cilësore, me përvojën e pasur më shumë se 10 vjecare në fushën e shërbimeve, trainimeve profesionale si dhe me modelin më efikas në fushën financiare, në atë organizative e menaxheriale.


Vazhdimësia

Gjatë vitit 2012 TLAS do të vazhdojë të ofrojë shërbimet e tij bazuar në misionin dhe objektivat e tij kryesorë të përcaktuar. Prioritet mbetet rritja dhe përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve, rritja e kapaciteteve organizative, si dhe ngritja e fondeve për vazhdimin e aktivitetit.

VII.

HISTORI TE VERTETA

Histori e vërtetë 1



Pranë Zyrës tonë rreth 1 vit e gjysem më parë u paraqit një kliente me iniciale A.B, pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet posterave të afishuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane ajo u paraqit duke kërkuar zgjidhjen e martesës me bashkeshortin e saj dhe zgjidhjen e pasojave në lidhje me fëmijet e saj pasi nga martesa ata kishin lindur tre fëmijë.

Divorcet këto vitet e fundit janë shtuar shumë për shkak të keqtrajtimit ose kryesisht për shkaqe ekonomike.

Gjendja e klientes A.B ishte mjaft e vështirë pasi ajo kishte edhe 3 fëmijë me bashkeshortin e saj dhe kërkonte t'i mbante ajo edhe pse ishte pa punë për momentin.

Duke parë vështirësinë e rastit të paraqitur u krye një intervistim i kujdesshem nga keshilltari i projektit për të qartësuar me shumë situatën ligjore dhe faktike të klientes A.B.

Nga intervista u konstatua se:

Bashkeshortet kishin lidhur martesë në vitin 2004 dhe nga martesa kishin lindur tre fëmijë. Në vitet e para të martesës marrëdhëniet bashkëshortore kishin qenë relativisht të mira, por me kalimin e viteve ato gradualisht filluan të përkeqësohen për shkak të ndryshimit të sjelljes së bashkeshortit të ndaj klientes A.B. Nga ana e bashkeshortit të saj kishte pasur raste të shpeshta dhune madje edhe në sy të fëmijëve duke krijuar një gjendje të vështirë psikologjike edhe për fëmijet e mitur. Klientja A.B dii se here i ishte drejtuar komisarëve të policisë për të denoncuar dhunën e bashkeshortit të saj por nga ana e tyre nuk ishte marrë asnjë masë shtrenguese ndaj tij.

Përpara rreth 5 muaj klientja A.B ishte larguar nga banesa bashkëshortore për shkak të dhunës së ushtruar nga bashkeshorti i saj. Në këto kushte i ishte drejtuar perseri komisarëve të policisë dhe kishte perpiluar një urdher mbrojtjeje drejtuar gjykatës për dhunën e ushtruar nga bashkeshorti i saj.

Në momentin që u paraqit të zyrat tona klientja A.B jetonte në shtëpinë e prindërve të saj dhe nuk mundi të punonte për shkak të frikës ndaj dhunës që mund të ushtronte bashkeshorti i saj. Gjithashtu fëmijet e mitur vazhdonin të jetonin me babain e tyre të dhunshëm i cili nuk i lejonte që të takonin nënën e tyre.

Në kushtet e përshkruara më lart klientja A.B kërkonte divorcin për disa nga shkaqet e përmendura më sipër si dhe kujdestarinë mbi fëmijet e saj të mitur. Nga intervista u konstatua se klientja A.B i plotëson kushtet për të përfituar ndihmë ligjore nga ana e zyrës tone.

U procedua me marrjen e dokumentave të nevojshëm për fillimin e gjyqit gje e cila mori pak kohë pasi duke marrë parasysh se klientja kishte qene disa here ne polici. U terhoq prane prokurorise se rrethit gjyqesor Tirane nje kopje e aktit mjeksor i cili vertetonte dhunen e ushtruar ndaj klientes A.B nga bashkeshorti i saj. Gjithashtu u terhoq prane gjykates se rrethit gjyqesor Tirane nje kopje e dosjes per urdherin e mbrojtjes. Nga zyrat e gjendjes civile u terhoqen certifikatat e nevojshme per fillimin e ceshtjes gjyqesore.

Pas plotesimit te dokumentave u hartua kerkese padia per fillimin e gjyqit. Keshtu ne baze te nenit 132 të Kodit të Familjes i cili parashikon “Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët”.

Ne baze te paragrafit te mesiperm dhe ne baze te provave te mbledhura u kerkua nga gjykata zgjidhja e marteses midis klientes A.B dhe bashkeshortit te saj.

Gjithashtu ne lidhje me pasojat e zgjidhjes se marteses u kerkua qe ne baze te nenit 155 te kodit te familjes i cili parashikon :” Para se gjykata te marre nje vendim te perkohshem ose perfundimtar lidhur me menyren e ushtrimit te pergjegjesise prinderore, te drejtes se vizites ose te besuarit te femijes njerit ish-bashkeshort, duhet te therrase nje psikolog ose punonjes social, i cili para se te jape mendimin, duhet te marre te dhena per gjendjen materiale dhe morale te familjes, kushtet ne te cilat jetojne dhe ku eshte me e pershtatshme te jetoje femija”.

Ne keto kushte ne kerkesepadi u kerkua qe te caktohej nje ekspert psikolog nga gjykata qe te vleresonte se me cilin nga prinderit ishte me mire qe te jetonin femijet.

Gjithashtu duke u bazuar ne nenin 138/1 I Kodit të Familjes i cili parashikon :”Në kërkesëpadinë për zgjidhjen e martesës mund të kërkohet edhe detyrimi i bashkëshortit tjetër për të përballuar shpenzimet për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, shpenzimet për jetesë të bashkëshortit nevojtar”.Ne baze te ketij neni u kerkua qe perindit qe nuk do ti besoheshin femijet per rritje dhe edukim te paguante ne favor te tyre nje shume te hollash te nevojshme per rritjen e tyre.

U depozitua padia ne gjykate dhe u zhvilluan me shume se 20 seanca gjyqesore. Gjithashtu nga gjykata u caktuan dy eksperte. Nje ekspert psikolog dhe nje punonjes social te cilet pasi vleresuan te gjitha kushtet dhe pas intervistave me te dy bashkeshortet dhe me femijet e mitur arriten ne perfundimin se femijet duhet te vazhdonin te ishin ne perkujdesjen e neves se tyre.

Gjykata pas një shqyrtimi gjyqësor te hollësishëm pikërisht për shkak të ekzistencës së 3 fëmijëve të mitur arriti ne përfundimin se kjo martesë nuk mund të vazhdonte dhe vendosi zgjidhjen e saj.Përsa i përket fëmijëve gjykata vendosi që ata të jetojnë me nënën e tyre per faktin e moshës së disa prej tyre por edhe per perkujdesje më të madhe nga ana e saj. U vendos edhe nje pension ushqimor për secilin nga fëmijët të cilin do e paguante babai i tyre sipas rregullave të vendosura nga gjykata.

Mbas një pune pothuajse 2 vjecare duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klientja A.B.

Histori e vërtetë 2



Pranë Zyrës tonë u paraqit një kliente rome me initiale S.S, e cila pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë u paraqit duke kërkuar që të përfaqësohej nga TLAS në procesin gjyqësor për zgjidhjen e martesës, e cila në fakt rezultoi të ishte pavlefshme martese.

Nga ana e zyrës u procedua në mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm për të kryer zgjidhjen e martesë në gjykatë. Gjatë mbledhjes së dokumentacionit u vu re në përgjigjet që ktheu Zyra e Gjendjes Civile pranë së cilës ishte e regjistruar klientja, se klientja figuronte e martuar në regjistra, por Zyra e Gjendjes Civile nuk mund të lëshonte Çertifikatën e Martesës, që nevojitet në gjykim për vërtetimin që ekziston martesa midis personave. Arsyeja që nuk mund të lëshohej kjo çertifikatë ishte për faktin se në regjistrat e gjendjes civile nuk figuronte asnjë Akt Martese midis klientes dhe bashkëshortit të saj. Kjo passillte problemin që në një rast të tillë nuk mund të procedohej me një padi për zgjidhje martese, pasi një martesë e tillë e pashoqëruar me një Akt Martese, do të thotë një martesë jo e lidhur para nëpunësit të gjendjes civile, kusht për vlefshmërinë e saj siç e kërkon shprehimisht Kodi i Familjes në Nenet 8 e 28 të tij.

Në kushte të tilla, mënyra ligjore për t'iu drejtuar Gjykatës për zgjidhjen e këtij problemi që doli i paparashikuar ishte vetëm me një padi për pavlefshmërinë e martesës. Kodi i Familjes në Nenin 42 të tij parashikon që “Martesa që nuk është lidhur publikisht përpara nëpunësit të gjendjes civile është e pavlefshme. Kërkesa mund të bëhet nga bashkëshortët, nga prindërit e tyre, nga të paralindurit, nga të gjithë ata që kanë një interes të drejtpërdrejtë si dhe nga prokurori.

Procedura në këtë lloj gjykimi është pothuajse e ngjashme me atë të zgjidhjes së martesës. Padia ngrihet duke thirrur si të paditur bashkëshortin, dhe e veçanta është që thirret edhe si person i trete Zyra e Gjendjes Civile, për shkak se ajo disponon aktet apo mund të japë shpjegime për aktet që nuk janë mbajtur në rastin konkret.

Klientja dhe bashkëshorti i saj kishin fëmijë të lindur gjatë bashkëjetesës së tyre. Lidhur me pasojat në rast të konstatimit të pavlefshmërisë së kësaj martese Kodi i Familjes në Nenin 49 të tij parashikon që “Martesa që shpallet e pavlefshme me vendim të formës së prerë konsiderohet se nuk është lidhur. Për bashkëshortin që nuk ka ditur shkakun e pavlefshmërisë së martesës, pasojat fillojnë nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Fëmijët e lindur nga një martesë që shpallet e pavlefshme, quhen sit ë lindur nga martesa dhe marrëdhëniet midis tyre dhe prindërve rregullohen si në rastet kur zgjidhjet martesa.

Neni 138/1 i Kodit të Familjes shprehet: “Në kërkesëpadinë për zgjidhjen e martesës mund të kërkohet edhe detyrimi i bashkëshortit tjetër për të përballuar shpenzimet për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, shpenzimet për jetesë të bashkëshortit nevojtar, në rastet e parashikuara në këtë Kod”.

Në padinë e paraqitur në Gjykatë, përveç sa më sipër u kërkua që fëmijët ti liheshin për rritje dhe edukim nënës së tyre (klientes së zyrës) duke qenë se ata kishin jetuar gjatë gjithë kohës me të dhe detyrimin e babait që të paguante detyrimin ushqimor deri sa të mbushin moshën madhore.

Pas kryerjes së të gjitha procedurave, hartimit të Raportit Psikologjik edhe nga psikologia e çështjes, gjykata mori vendim për shpalljen e pavlefshmërisë së kësaj martese, lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim nënës së tyre, të drejtën e babait për ti takuar, dhe detyrimin e tij për të paguar pension ushqimor për fëmijët deri kur ata të arrinin moshën madhore.

Histori e vërtetë 3



R.I erdhi në zyrën e TLAS shumë e shqetësuar. Ajo na shpjegoi se kishte pesë fëmijë të paregjistruar në gjëndjen civile. Vajza e saj me e madhe ishte 18 vjeç dhe vajza më e vogël ishte 5 vjeç. Ndërkohë, vajza e saj më e madhe kishte lindur tre fëmijë, që edhe ata nuk ishin të regjistruar në gjëndjen civile. Nga biseda e saj mësuam se familja e saj jetonte në varfëri të madhe. Asnjë prej fëmijëve nuk kishte shkuar në shkollë dhe djali më i madh, 15 vjeçar duhet të punonte për të ndihmuar familjen. Babai i fëmijëve punonte herë pas here, kur gjente punë. Ata jetonin në një barakë të marrë me qira, pa elektricitet dhe pa ujë.

Duke vazhduar bisedën me R.I. zbuluam që përpara se të fillonin procedurat e regjistrimit të fëmijëve, duhet të bëheshin edhe shumë veprime të tjera.

1. R. I. e kishte regjistrimin në komunën B. shumë të largët në veri lindje të Shqipërisë. Ajo figuronte atje si e martuar me S. I. Në fakt, ata ishin martuar dhe kishin jetuar sëbashku për disa muaj dhe nuk kishin patur fëmijë. Më vonë, R. I. Ishte larguar nga bashkëshorti dhe kishte filluar të bashkëjetonte me L. L. dhe nga bashkëjetesa kishin lindur pesë fëmijë. Katër prej fëmijëve kishin lindur në spital dhe një tjetër (djali i madh) kishte lindur në kushte shtëpie. Nga dokumentat e lëshuara nga spitali për të katër fëmijët (çertifikatat e asistencës në lindje), shihej që nëna kishte raportuar në maternitet emrin R. L. Pra nëna kishte raportuar mbiemrin e babait të fëmijëve si mbiemër të saj, gjë që ishte e gabuar, sepse në regjistrat e gjendjes civile ajo nuk njihej me mbiemrin “L”. Nga ana tjetër, S. I., burri që figuronte i martuar legalisht me R. I., jetonte me një grua tjetër në komunën B. dhe nga bashkëjetesa kishin patur pesë fëmijë të tjerë. Këta fëmijë ishin regjistruar në kohë në gjëndjen civile, për shkak se nëna e tyre kishte dhënë në maternitet mbiemrin e duhur dhe babai i tyre u kishte njohur atyresinë.

Veprimi i parë që duhet të bëhej ishte fillimi i procedurave të zgjidhjes së martesës në gjykatën e Kukësit, ku përfshihej komuna B., ku R. I. ishte e regjistruar. Gjyqi nuk mund të zhvillohej nëse R. I. nuk ishte e pajisur me letërnjoftim. Nga ana tjetër, komuna ndodhet larg nga Tirane dhe na duhej të fitonim kohë. Për këtë arsye, mbas disa përpjekjesh, TLAS kontaktoi me telefon personin që figuronte si bashkëshort i R. I. Ai kishte letërnjoftim dhe ishte shumë i intreresuar për zgjidhjen e martesës dhe për këtë arsye pranoi që avokati i TLAS të hartonte kërkesën për zgjidhje martese në emër të tij dhe të ndiqte procedurat në gjykatë. Punonjësja e gjendjes civile të komunës B. ndihmoi mjaft për të kontaktuar S. I., si dhe për t'i dorëzuar atij për firmë kërkesën për gjykatë, që TLAS e dërgoi me postë. Avokati i TLAS ndoqi të gjitha procedurat gjyqësore, deri kur u arrit zgjidhja e martesës dhe R. I. morri mbiemrin e saj të vajzërisë, "T".

2. Hapi i dytë ishte transferimi i R. T. nga komuna B. në Tiranë. Për këtë arsye, nevojitej një kontratë qiraje me personin që kishte dhënë me qira barakën e tij. Mbas përgatitjes së kontratës së qirasë dhe marrjes së çertifikatës për leje banimi nga komuna B., R. T. u transferua në Tiranë, në të njëjtën zyrë të gjendjes civile ku ishte i regjistruar edhe personi me të cilin ajo bashkëjetonte prej 20 vjetësh dhe që ishte babai i fëmijëve të saj. Aty R. T. aplikoi për letërnjoftim dhe e morri atë.

3. Hapi i tretë ishte përgatitja e procedurave të martesës. Në zyrën e gjendjes civile u bë shpallja dhe mbas 11 ditëve u realizua lidhja e martesës. Mbas martesës mbiemri i R. T. u bë R. L. Ky ishte edhe mbiemri i raportuar prej saj në maternitetet dhe që figuronte në çertifikatat e asistencës në lindje të lëshuara nga maternitetet ku ajo kishte lindur katër, ndër pesë fëmijët e saj. Mbas martesës, ajo aplikoi për letërnjoftim tjetër, me mbiemrin që ajo morri mbas martesës, pra R. L.

4. Duke arritur në këtë fazë, nuk ishte e vështirë të regjistroheshin katër fëmijët e R. L. Ajo u paraqit në zyrën e gjendjes civile sëbashku me bashkëshortin e saj, që bëri njohjen e atësisë së fëmijëve. Përfundimisht, katër fëmijët e saj u regjistruan, duke patur tashmë mundësi të përfitonin të gjitha të drejtat e tyre nga sistemi shëndetësor, të mund të ndiqnin shkollën, etj. Familja tashmë u plotësua (jo plotësisht) dhe tashmë mund të aplikonin për ndihmë ekonomike nga shteti dhe mund të përfitonin nga programet e strehimit të bashkisë së Tiranës. Mbas regjistrimit, vajza e tyre e madhe mund të fillonte procedurat e regjistrimit të tre fëmijëve të saj, të paregjistruar në gjendjen civile.

5. Djali i paregjistruar 15 vjeçar i R. L. kishte lindur në shtëpi dhe familja nuk kishte ndonjë dokument për të provuar lindjen e tij. Sipas ligjit të gjendjes civile, regjistrimi i fëmijës mund të bëhet vetëm mbas një vendimi të gjykatës. TLAS ka filluar tashmë këto procedura gjyqësore, duke siguruar fillimisht të gjitha provat që nevojiten në gjykatë. Mbas regjistrimit të fëmijës së pestë, mund të themi që jeta e kësaj familjeje do të jetë plotësisht e normalizuar.

Histori e vërtetë 4



Pranë zyrës së Shërbimit Ligjor Falas u paraqit një kliente me inicialet S.B. Kjo kliente u referua në zyrën tonë nga Qendra për mbrojtjen e fëmijëve, pranë Bashkisë Tiranë.

Klientja është gjyshja e katër fëmijëve të mitur. Të katër këta fëmijë janë fëmijët e vajzës së saj te moshes 14, 11, 10 dhe 3 vjeç.

Vajza e klientes tre prej fëmijëve i ka lindur nga martesë, ndërkohë fëmijën e tretë e ka lindur nga një marrëdhënie jashtëmartesore.

Klientja S.B ishte nena e L.G, vajza e saj, e cila ishte e martuar me tre djem nga martesë dhe ishte braktisur nga bashkeshorti 6 vjet më parë. Ndërkohë vajza e klientes kishte një tjetër fëmijë jashtë martesës, një vajzë të moshës tre vjeç. Ajo ka ndekur procedurat e zgjidhjes së martesës me ndihmën e TLAS disa vite më parë dhe aktualisht ajo vuan nga probleme mendore të cilat përkeqsohen dita ditës.

Vajza e vogël ishte e paregjistruar. Babai i saj nuk ishte interesuar asnjëherë për te dhe gjithashtu nënë e saj, vajza e klientes nuk dihej se ku ndodhej prej disa muajsh. Fillimisht ishte e nevojshme që fëmija të regjistrohej dhe më pas të niste procedura për marjen e saj në kujdestari nga gjyshja, klientja S.B, e cila ishte faktikisht i vetmi person që kujdesej për të.

Procedura e regjistrimit të fëmijës u bë në përputhje me urdhrin nr. 07 datë 10.01.2012, i cili ka dalë në zbatim të Ligjit për Gjendjen Civile e që rregullon procedurën e regjistrimit të fëmijëve të paregjistruar të cilët nuk kanë asnjërin prej prindërve (për arsye të ndryshme). Fëmija u regjistrua në fletë familjare më vehte.

TLAS konsideroi mundësinë e vendosjes së djalit të madh në një qendër rezidenciale, psh pranë “Fshatit SOS”, kjo jo vetëm për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të klientes por edhe për faktin se djali ndodhej në një moshë mjaft delicate dhe kishte nevojë për mbrojtje, edukim dhe akomodim. Pasi një sërë dokumentash u mblodhën dhe u përgatitën nga Këshilltari Paraligjor i TLAS, djali i madh 14 vjeçar po shkon tashmë shumë mirë në “Fshatin SOS”, vazhdon shkollën dhe është nën kujdestarinë e përkohshme të institucionit.

Për tre fëmijët e tjerë përfshirë edhe vajzën e vogël 3 vjeçare e cila ndërkohë u regjistrua në gjendjen civile, TLAS vendosi të hapë çështjen gjyqësorë të kujdestarisë, në mënyrë që gjyshja të caktohej nga gjykata si kujdestare ligjore dhe të kishte përgjegjësi për këta fëmijë në cdo institucion shtetëror dhe akses në programet social-ekonomike.

Ishte e vështirë për avokatin e TLAS të ishte bindës përpara Gjykatës nëpërmjet provave, sepse prindërit e fëmijëve nuk ishin bashkëpunues në favor të interesit më të lartë të fëmijëve të tyre. Prindërit e fëmijëve gjithashtu nuk ju përgjigjën asnjëherë ftesave të Gjykatës për të qënë present në seancat gjyqësore. Nena e fëmijëve nuk ishte e aftë mendërisht për të ushtruar përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijëve të saj dhe nga ana jonë

ishite e nevojshme që të provonim përpara gjykatës gjendjen e saj nëpërmjet raporteve mjeksore.

Duke ju referuar Kodit të Familjes nenit 263, thuhet se : *“Fëmijët e mitur vendosen ne kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje te veçante nga shteti kur prindërit e tyre janë ne pamundësi për te ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se te dy prindërit kane vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si te pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për te vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër te pranuar nga gjykata.*

Gjykate kompetente për vendosjen ne kujdestari te te miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit te te miturit”

Gjithashtu në nenin nenit 269 parashikohet: *“Për të miturit që janë vëllezër dhe motra caktohet një kujdestar I vetëm, përvec rastit kur rrethanat e vecanta kërkojnë domosdoshmërinë e caktimit të më shumë se një kujdestari”.*

Kështu, referuar edhe bazës ligjore të sipërcituar, gjyshja e fëmijëve mund të caktohej nga Gjykata si kujdestarja e vetme e tre fëmijëve të mitur.

Në gjykimin e kësaj çështjeje në gjykim mori pjesë edhe Sektori Shërbimit Social pranë Bashkisë Tiranë, të cilët pregatitën një raport të detajuar vlerësimi lidhur me kushtet sociale ekonomike të klientes S.B. Gjithashtu gjykata caktoi një psikolog I cili gjithashtu pregatiti një raport vlerësimi I cili konfirmoi shkallën e atashimit të fëmijëve me gjyshen e tyre dhe me prindërit respektivë.

U provua përpara gjykatës që gjyshja ishte i vetmi person i përshtatshëm për t’u caktuar kujdestar për fëmijët e mitur dhe kjo ishte gjithashtu në interesin më të lartë të tyre.

Nëpërmjet këtij vendimi gjyqësor për vendosjen e fëmijëve në kujdestari, fëmijët janë më të sigurtë dhe më pak konfuzë nga mënyra e prindërimit të prindërve të tyre të cilët shpesh herë edhe kishin përfituar në emër të tyre duke marë ndihmën ekonomike si të papunë apo si familjarë më shume fëmijë.

Histori e vërtetë 5



Në zyrën tonë u paraqit klientja me inicialet F.K, për të gjetur zgjidhje lidhur me problemin e saj.

Kjo kliente jetonte sëbashku me vëllain e saj në moshë madhore, i cili vuante nga një prapambetje e rëndë mendore prej shumë vitesh. Klientja F.K interesohej që të merrte kujdestarinë ligjore për vëllain e saj, edhe pse prej shumë vitesh ajo ishte kujdestarja e

vetme faktike e këtij personi.

Në këto kushte u fillua nga puna për mbledhjen e provave dhe paraqitjen e rastit në gjykatë.

Zgjidhja e rasteve të tilla ka një rëndësi të vecantë pasi nuk kemi të bëjmë thjesht me vendosjen e kujdestarisë ndaj një personi, por edhe me heqjen e zotësisë për të vepruar, e cila nënkupton një lloj zhdukjeje civile të personit, pra e bën atë të paafte për të gëzuar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.

Bazuar në përcaktimin e Kodit të Procedurës Civile, në nenin 382 thuhet se “ Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, bëhet me kërkesë të bashkëshortit, gjinisë së afërt, të prokurorit dhe të personave që kanë interes të ligjshëm për këtë fakt .

Kërkesa i paraqitet gjykatës së vendit ku ka banimin personi që kërkohet t’i hiqet apo kufizohet zotësia për të vepruar”. Pra, ne ,ishim në kushtet e përcaktuara nga ligji për të ngritur kërkesëpadinë, pasi klientja F.K. legjitimohej si kërkuese.

Edhe procesi i gjyimit të këtyre rasteve ka gjithashtu disa faza dhe bazuar në nenin 383 të Kodit të procedurës Civile “...gjykata vendos lidhur me kërkesën, pasi të ketë pyetur personin për të cilin kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, persona nga gjinia e afërt e tij, mjekun që e ka kuruar ose pasi të ketë marrë mendimin e mjekëve të tjerë ekspertë, si dhe prova të tjera që do t’i çmojë të nevojshme ...”.

Pas sigurimit të të gjitha provave të nevojshme për gjykimin u procedua me hartimin e kërkesëpadisë dhe dërgimin e cështjes në gjykatë.

Deri në këtë fazë rasti nuk paraqiti vështirësi, ndaj u procedua me mjaft efikasitet.

Në fazën e gjyimit, për shkak të parashikimit që bën vetë ligji gjykimi duhet të kalojë në disa faza. Fillimisht u procedua me pyetjen nga ana e trupit gjykues të vetë personit për të cilin ishte vënë në lëvizje gjykata.

Për të pyetur persona të tjerë të afërt në gjini ishte e vështirë të ishin të pranishëm në këtë gjykim pasi klientja F.K nuk kishte asnjëlloj kontakti me motrat dhe vëllezërit e saj. Për arësye familjare ata kishin krijuar distanca me njëri- tjetrin. Pavarësisht përpjekjeve tona dhe të gjykatës që ata të paraqiteshin në gjykim, kjo nuk u bë e mundur nga ana e tyre. Për këtë arësye ne proceduam me thirrjen në cilësinë e dëshmitares të fqinjes së klientes F.K e cila u paraqit në gjykim për t’ju përgjigjur pyetjeve tona dhe të gjykatës lidhur me cështjen. Një problem tjetër që doli gjatë gjyimit ishte thirrja e mjekut i cili ishte marrë në vite me kurimin e personit. Në këtë moment ndeshëm rezistencë nga ana e mjekut i cili nuk pranonte të vinte në gjykim pavarësisht edhe thirrjeve sistematike të realizuara nga gjykata. Kjo situatë bëri që gjykimi të shtyhej disa herë dhe gjithashtu e vështirësoi mbrojtjen tonë pasi, në rast të mosparaqitjes së mjekut që ishte marrë me mjekimin e personin, gjykata ishte e detyruar të thërriste mjekë të tjerë në cilësinë e ekspertit në cështje dhe si rregull ekspertët duhet të paguhen për aktin e ekspertimit që kryejnë nga personi që vë në lëvizje gjykatën. Në këtë rast do të ishte e pamundur që klientja dhe zyra jonë të përballonte këto shpenzime. Për këtë arësye stafi ynë u impenjua që rasti të gjente një zgjidhje brenda të gjitha mundësive të shërbimit që ofron Shërbimi Ligjor Falas. Për këtë arësye u gjetën mënyrat për të kontaktuar disa herë me mjekun i cili e kishte kuruar vëllain e klientes F.K.

Pas shumë përpjekjeve ai pranoi që të vinte të dëshmonte në cilësinë e dëshmitarit në gjykim.

Pas kësaj faze, gjykimi mori efikasitetin e duhur. Pas mbledhjes së të gjitha provave dhe dëshmive duke i shtuar edhe mendimin e Sektorit të Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Tiranë të cilët ishin thirrur si palë e tretë e interesuar në gjykim, për të dhënë mendimin lidhur me vendosjen e kujdestarisë. Pasi u administruan të gjitha provat, Gjykata më në fund u tërhoq për të dhënë vendimin e saj. Në fund ajo vendosi sipas objektit të kërkesës, duke hequr kështu zotësinë për të vepruar të shtetasit në fjale dhe duke caktuar si kujdestare ligjore klienten tone F.K.

Histori e vërtetë 6



K.C. kishte lindur një vajzë në një maternitet të Greqisë, por ajo ishte larguar nga materniteti vetëm me një libër shëndeti të fëmijës dhe me asnjë dokument tjetër. Në zyrën e gjëndjes civile ku ajo është e regjistruar, nuk ja pranonin librin e shëndetit si dokument për regjistrimin e fëmijës. Vajza ishte bërë tashmë 7 vjeç dhe vazhdonte të mos ishte e regjistruar në gjëndjen civile.

Me ndihmën e Shërbimit Ligjor Falas (TLAS), K.C. arriti ta regjistrojë vajzën në shkollë, duke mundur të paktën fillimin e shkollimit të saj, por K.C. e kuptonte se regjistrimi në gjëndjen civile ishte shumë i rëndësishëm për të mundur identifikimin e vajzës së saj dhe për t'i siguruar asaj të gjitha të drejtat kushtetuese, si çdo shtetas tjetër shqiptar.

TLAS filloi një punë të gjatë dhe të komplikuar për përmbushjen e kërkesave ligjore për regjistrimin e fëmijës së lindur jashtë shtetit. Për këtë ndoqi një sërë hapash:

1. Bëri përkthimin e të dhënave në Librin e Shëndetit të Fëmijës, nga nxorri emrin me të cilin ishte regjistruar nëna, dhe të dhënat e tjera si data e lindjes së fëmijës, emri i qytetit të lindjes, etj.
2. Realizoi pajisjen e nënës, K.C. me letërnjoftim elektronik.
3. Morri tek noteri një prokurë nga nëna, ku autorizojë avokati i TLAS për tërheqjen e çertifikatës së lindjes nga materniteti i Greqisë dhe për ndjekjen e procedurave të legalizimit të kësaj çertifikate.
4. Bëri legalizimin e prokurës në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.
5. Bëri legalizimin e mëtejshëm të prokurës në ambasadën greke në Tiranë.
6. Më tej, procedurat vazhduan në Greqi. Si hap i parë, ishte përkthimi i prokurës nga shqipja në greqisht dhe noterizimi në një zyrë të autorizuar nga shteti grek.
7. Si hap i dytë, ishte kërkesa për tërheqjen e çertifikatës së lindjes së fëmijës, në maternitetin ku K.C. kishte lindur fëmijën. Kjo u realizua nëpërmjet plotësimit të një formulari, ku kërkoheshin të dhënat e personit të autorizuar për tërheqjen e çertifikatës së lindjes, si dhe të dhënat e nënës.
8. Mbas disa ditësh u tërhoq çertifikata e lindjes së fëmijës nga materniteti.
9. Çertifikata më tej, u vërtetua në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Greqisë.
10. Hapi përfundimtar ishte legalizimi i çertifikatës në konsullatën shqiptare.

Duke patur në dorë këtë çertifikatë, K.C. mundi të realizojë regjistrimin e vajzës së saj në zyrën e gjëndjes civile. Tashmë vajza ka mundësi të pajiset edhe me librezë shëndetësore dhe mbi të gjitha, më në fund ajo është shtetase shqiptare.

Histori e vërtetë 7



Pranë Zyrës tonë u paraqit një kliente e qytetit të Elbasanit me iniciale L.R. Pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme të krujuara nga programi i Shërbimit Ligjor Falas nëpërmjet aktiviteteve në komunitet me anë të studentëve që studiojnë për drejtësi, ajo u paraqit duke kërkuar rregjistrimin e lindjes së dy fëmijëve të saj.

U krijuan disa kontakte me të në qytetin e Elbasanit dhe disa takime në Tiranë pasi klientja vazhdimisht qëndronte në Tiranë për të punuar ndërsa gjëndjen civile e kishte në qytetin e Elbasanit.

Nga intervista u konstatua se klientja L.R kishte lindur dy fëmijë nga martesë me shtetasin F.R dhe pavarësisht se lindjet kishin ndodhur jashtë institucioneve të njohura nga ligji ato nuk ishin deklaruar përpara nëpunësit të gjëndjes civile. Gjithashtu nga intervista me klienten L.R u konstatua se një ndër shkaqet që kishin penguar regjistrimin e fëmijëve të saj ishte pikërisht fakti se klientja L.R e kishte pashaportizimin në qytetin e Elbasanit dhe vetë jetonte e punonte në Tiranë, gjithashtu edhe për shkak të mosnjohjes së ligjit ajo nuk kishte bërë asnjë deklaram të lindjes së fëmijëve përveç faktit që kishte kryer vaksinimin e tyre. Gjithashtu bashkëshorti i saj ndodhej në burg kështu që ajo nuk kishte mundur të kryente e vetme regjistrimin e fëmijëve të saj.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin që të përpilohej dhe të ndiqej procedura gjyqësore për regjistrimin e fëmijëve të saj.

U vendos të procedonim me regjistrimin e fëmijëve pranë zyrës së gjëndjes civile të Elbasanit. Duke qenë se klientja L.R kishte probleme pasi nuk mund të shkëputej nga marrëdhëniet e punës u mendua që të përpilohej një prokurë ku ajo të autorizonte një nga avokatët e zyrës që të realizonte të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e dy fëmijëve të saj. Pasi u përpilua prokurë, avokatët e zyrës shkuan në qytetin e Elbasanit

U mblodhën të gjitha dokumentat që vërtetonin faktin e lindjes së fëmijëve të klientes L.R në qytetin e Elbasanit dhe në Tiranë njëkohësisht.

Të gjitha këto dokumenta u paraqitën në Gjykatën e Rrethit të Elbasanit që i takonte vendbanimit të kërkuësës duke u shoqëruar edhe me një kërkesë nga ana e saj për të bërë të mundur regjistrimin.

Më pas u procedua me ndjekjen e gjyqit për regjistrimin e fëmijëve dhe që u finalizua me vendimin e gjykatës për ti dhënë të drejtë kërkueses L.R në kërkimin e saj për regjistrimin e dy fëmijëve të saj., Me vendimin e gjykatës bashkë me kërkuesen u paraqitëm në zyrat e gjëndjes civile dhe me dokumentat e gjyqësore arritëm të bëjmë të mundur regjistrimin e fëmijëve në fletën familjare të nënës së tyre.

Kështu këta fëmijë mund të gëzojnë dhe të përfitojnë të gjitha të drejtat që ju njih ligji. Vlen të theksohet se problemet që kemi hasur gjatë punës me popullsinë Rome janë mjaft të ndërlikuara, por pavarësisht këtyre pengesave Zyra për Shërbimin Ligjor Falas ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme që ti vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit Rom të Tiranës por edhe atij komuniteti që banon në qytete të tjera të Shqipërisë.

Histori e Vërtetë 8



Një fenomen shqetësues i pranishëm është ekzistenca e personave të vdekur të cilët vazhdojnë të jenë të regjistruar në regjistrat e Gjëndjes Civile.

Ky problem konsiderohet mjaft i rëndësishëm pasi këta persona të cilët kanë vdekur dhe vazhdojnë të jenë të regjistruar në regjistrat e Gjëndjes Civile kanë krijuar shumë probleme në lidhje me çështje të tjera si problemet e pronësisë, trashëgimisë, listat e zgjedhësve, etj.

Neni 52/3 i ligjit “Për Gjëndjen Civile” parashikon: “Deklarimi i vdekjes bëhet brenda 10 ditëve nga ndodhja ose gjetja e kufomës dhe brenda 60 ditëve, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit”.

Një rast i tillë u paraqit edhe në zyrën tonë, klienti I.B. kërkonte vërtetimin e faktit të vdekjes së djalit të tij në vitin 1992 në një aksident automobilistik. Neni 52/1 i Ligjit “Për Gjëndjen Civile” parashikon: Deklarimi i vdekjes bëhet nga çdo pjesëtar i familjes ose i afërt e, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga i ngarkuari i posaçëm i bashkisë ose komunës ku ka banuar ose është gjetur i vdekuri.

Dokumenti bazë që shërben në këto raste është “Akti i Vdekjes” gjë e cila parashikohet shprehimisht nga neni 51/1 i ligjit “Për Gjëndjen Civile”: Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, në të cilin saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij.

Por në rastin e paraqitur në Zyrën tonë klienti I.B nuk dispononte dokumentin bazë “Akt Vdekje”. I vetmi dokument që dispononte ishte një vendim i prokurorit për pushimin e çështjes në ngarkim të drejtuesit të mjetit që kishte shkaktuar aksidentin, në të cilën përshkruheshin rrethanat e ngjarjes, dhe ku përmendej madje edhe emri i viktimës dhe po ashtu edhe fakti i humbjes së jetës. Mirëpo që rasti të ishte më bindës për gjykatën në

mënyrë që të vendoste në favor të klientit, u orientua klienti për mundësinë e paraqitjes së dëshmitarëve që kishin dijeni për ngjarjen dhe po ashtu për një vërtetim të lëshuar nga organet e pushtetit vendor që kanë nën administrim varrezat. Mbas diskutimit me avokatët e Zyrës u mendua që çështja të paraqitej në gjykatë me objekt “Vërtetim Fakti i vdekjes” sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile.

Pasi u mbledhën dokumentat u përpilua kërkesa për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe u paraqit kërkesa në gjykatë.

Pas disa seancave gjyqësore gjykata arriti në përfundimin se e gjente të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e bërë nga klienti I.B duke i dhënë të drejtë për kërkimin e tij.

Në këto kushte u arrit në përfundimin e kërkuar nga klienti I.B dhe u vlerësua puna e bërë nga Zyra për Shërbimin Ligjor Falas për zgjidhjen e kësaj çështje.

Tirane, 30.03.2012